



# *Pse është i rëndësishëm izolimi*

*Rezymeja e raportit për  
qëndrueshmëri 2010*

## Roli ynë

**Kompania Knauf Insulation gjatë dhjetë viteve të kaluara ka realizuar një rritje evidente dhe është bërë kompania e tretë më e madhe në botë në sferën e izolimit. Krahas kësaj rritjeje, është shtuar edhe ndikimi ynë në mjedisin e jetesës, e vetëvetiu pra edhe obligimi ynë që këto ndikime ti menaxhojmë me përgjegjësi.**

Tani është momenti për një shtim akoma më me përgjegjësi. Një hap i rëndësishëm në këtë proces është publikimi i raportit tonë të parë korporativ për qëndrueshmërinë dhe i kësaj rezymeje. Në këto publikime i kemi shtruar idetë tona të sfidave me të cilat do të ballafaqohet industria e ndërtimit gjatë dhjetë viteve të ardhshme, kemi theksuar se do tu përgjigjemi këtyre sfidave me zhvillimin e prodhimeve dhe të asortimenteve tona, dhe më në fund si kompani do ta përparojmë punën tonë. Shtimi i kujdesit ndaj punës me përgjegjësi duhet të bazohet në objektiva konkrete, për këtë shkak neve edhe kemi shtruar para vetit obligime për të cilat po flasim në këtë broshurë (shikoni çelsin në fund) – të gjitha detajet janë dhënë në faqen 9. I kemi fokusuar në sisteme progresive të menaxhimit, për mirëqenien e të punësuarve, logjistikë të qëndrueshme dhe komponente alternative të prodhimeve tona. Jemi obliguar të krahasojmë objektivat tona me ato ndërkombëtare dhe të vendosim mekanizma në mënyrë që t'i realizojmë ambiciet tona.

### Tony Robson

Shenja e obligimit  
Përshkrimi

00 Obligimi

#### Përmbajtja

1. Pasqyra e efekteve dhe e rezultateve të arritura
2. Përparimi i ndërtesave
4. Prodhimet tona
6. Kompania jonë
9. Obligimet tona

*Janë duke përparuar raportet me të punësuarrit dhe me palët e interesuara në lidhje me çështjet që kanë rëndësi të përgjigthshme dhe që ndikojnë në punën tonë. Na tregoni mendimin tuaj për punën tonë dhe raportin tonë në mënyrë që të marrim mësimet e të perfeksionohemi edhe më tepër.*

Na kontaktoni:  
sustainability@knaufinsulation.com



## Kronologjia e punës dhe e rezultateve të deritashme

### Efekti ynë

**LTA\* shkalla e frekuencës në krahasim me vitet 2008 e 2009 është zvogëluar**  
Në fabrikat tona shkalla LTA e frekuencës është zvogëluar prej 43 në 29.

**Numri i orëve të edukimit për një punëtor mesatarisht ka qenë 19,5 orë.**  
Jemi duke vazhduar punën tonë në drejtim të edukimit më të mirë të punëorëve në Kompani Knauf Insulation.

**Përdorimi i energjisë në vitin 2009 është zvogëluar në krahasim me vitin 2008.**  
për MWh për një tonë prodhimi.

**Përdorimi i ujit**  
Përdorimi është zvogëluar, mirëpo lëshimi i ujërave është shtuar - jemi duke bërë kërkime pse ka ndodhur kështu

**Emisioni CO2 është zvogëluar për 10%**  
Me burime të reja e të rindërtuara që i presim gjatë vitit 2011, shpresojmë se kjo përqidje do të jetë edhe më e madhe.

**\* Shkalla e efektit negativ të orarit të humbur të punës për shkak fatkeqësish të ndryshme**

### Rezultatet tona

**Prodhimi global izolues për vitin 2009.**  
është shpallur si prodhim më i mirë në Konferencën globale kushtuar izolimit e cila në veçanti është fokusuar në qëndrueshmërinë e industrisë

**DuBo Award 2009**  
Çmimi i parë për Inovacione revolucionare në ndërtim të qëndrueshëm (Holanda)

**Kompania e Ndërtimit për vitin 2009.**  
Kategoria e prodhimeve ndërtimore dhe teknologjia (Poloni)

**Çmimi për inovacion për vitin 2009**  
Asociacioni i Zhvillimit të Inovatorizmit të Republikës së Çekisë

**Prodhimi ndërtimor dhe teknologjia për vitin 2009.**  
Medalja e bronzitë (Republika e Çekisë)

**Çmimi "Save the energy"**  
Në kategorinë "Teknologjia më e mirë për kursimin e energjisë në termoizolim" (Rusi)

## Ndikimet tona në qëndrueshmëri

**Ndikimet tona në qëndrueshmëri mund të klasifikohen në tri sfera : përparimi i ndërtesave, prodhimet inovatorike dhe afarizmi përgjegjës.**

Pason rezymea për këto tri sfera kryesore të qëndrueshmërisë për vitin 2010. Në disa faqe pasuese do të lexoni si Knauf Insulation do të përparojë edhe më shumë e jo të jetë vetëm prodhues i izolimit duke mbështetur fuqimisht ndërtim rinë dhe duke reduktuar gati në zero shpenzimin e energjisë (faqet 2 e 3), duke ofruar prodhime që u ndihmojnë klientëve e arkitektëve të kenë ndërtesa të qëndrueshme (faqet 4 e 5) duke ndryshuar procesin e prodhimit në mënyrë që të funksionojë më një përgjegjësi dhe qëndrueshmëri më të mirë (faqet faqet 6-9).



Download i raportit të plotë  
[www.knaufinsulation.com/en/node/1913](http://www.knaufinsulation.com/en/node/1913)





### Problemi i shfrytëzimit të resurseve energjetike

Ndoshta e kemi arritur nivelin maksimal në eksplotim dhe prodhimin e karburanteve të fosileve: është e logjikshme nga aspekti ekonomik dhe aspekti i mjedisit të jetesës për të qenë efikas në shfrytëzimin e energjisë.



### Temperatura e ajrit gjithnjë më e madhe

Ky fenomen evident i nxemjes globale shkakton konflikte dhe rrezik komercial.

# 460m

Dioksidkarboni me tonelatë që është në ndërtesa e që mund të zvogëlohet për çdo vit.

# € 270bn

Shpezimet e Bashkimit Europian për shkak të efikasitetit të dobët energjetik.

Veni re: shifrat e theksuara vlejën vetëm për Europën

## Pse është i rëndësishëm izolimi?

**Izolimi është i rëndësishëm, sepse 40% συνολικής të energjisë së përgjithshme shfrytëzohet nëpër ndërtesa, çka është më shumë se sa shpenzohet në transport dhe industri. Mirëpo ndërtesat joefikase akoma po ndërtohen edhe pse ekzistojnë solucione tjera që bëjnë të mundshëm ndërtimin e objekteve në të cilat shfrytëzimi i energjisë është gati baraz me zero.**

Shfrytëzimi i energjisë ndikon në ndryshime klimatike dhe ndikon negativisht në sigurinë energjetike që është si kërcënim kryesor për shoqërinë dhe biznesin. Jemi duke rrezikuar që të jemi gjenerata e cila ka ditur se çka është dashur të bëhet por që nuk ka marrë hapin e duhur dhe nuk ka ndryshuar asgjë.

Kurse detyra që shtrohet është shumë e madhe: qeveritë, kompanitë dhe individët duhet të kuptojnë se çfarë potenciali ekziston në ndërtesa. Për këtë arsye, për të përmbushur obligimin tonë, Knauf Insulation bën përpjekjet mëdha të prodhojë izolime me cilësi të lartë, të edukojë nerëzit për ndërtimin e tij

cilësor dhe të angazhojë qeveritë dhe akterët e tjerë në lidhje me rëndësinë e izolimit dhe të reduktojë shpenzimin e vet të energjisë.

### 10 Obligimi

Konsumi i energjisë në ndërtesa

Shikoni faqen 9 për të gjitha detajet.

*Prej Venedikut e deri në Shangaj prej Nju-Jorkut e deri në Londër, qytetet tona bregdetare po ballafaqohen me rreziqe të ndryshme nga vërshimet që mund të shfaqen në të ardhmen. Ndërtesat luajnë rol vendimtar në zvogëlimin e këtij rreziku.*

*Në sajë të legjislacionit europian të gjitha ndërtesat e reja mbarë Bashkimit Europian duhet të kenë shpenzimin e enregjisë deri më 2020 baraz me zero. Mirëpo, kjo vetëm do të pengojë veshhtërsimin e mëtejshëm të problemit. Për të eliminuar karbonin nga ambienti tanimë i ndërtuar, gati të gjitha ndërtesat ekzistuese, deri në vitin 2050, duhet t'i nënshtrohen renovimit të përgjithshëm me qëllim të shtimit të efikasitetit energjetik.*

## Si Knauf Insulation ndihmon për ndryshimin e situatës

**Gjatë viteve të ardhshme ambienti i ndërtuar do të ndryshojë në mënyrë radikale meqenë se kërkesat për ndërtesa me energji minimale do të jenë të obligueshme. Ky ndryshim do të ndikojë që mjediset e ndërtuara deritani të jenë më të qëndrueshme, mirëpo ky ndryshim kërkon të realizohet ashtu di duhet.**

«Ndërtimi zinxhir» kërkon një mbështetje të konsiderueshme për të pasur ndërtesa që shpenzojnë sa më pak energji dhe që janë funksionale në praktikë, e jo vetëm në letër. Knauf Insulation krijon lidhjet e veta me qeveritë e ndryshme dhe do të ketë rol aktiv në përpjekjet që bën Europa për zhvillimin e standardeve për efikasitetin real energjetik të ndërtesave.



### HOMESTAR ,rregullativa ligjore

Takimi me Presidentin e SHBA Barack Obama për të diskutuar në lidhje me HOMESTAR-in e rregullativës ligjore e cila gjendet në procedurë.

### COP 15

Asistimi në COP 15

- Konferenca e KB për ndryshimet klimatike, e cila do të mbahet në Kopenhagë



## Prodhimet tona të qëndrueshme janë në zemër të ndërtesave të qëndrueshme

### 6 javs

AKoha që përafërsisht nevojitet që leshi mineral qelqor 040 (200mm) në çati të pjerrëta ta kthejë energjinë e cila është shpenzuar në prodhimin e tij.

### 9 javë

Koha e cila përafërsisht nevojitet që leshi guror mineral 035 (100mm) në mure ta jashtme të kthejë energjinë e cila është shpenzuar për prodhimin e tij.

### 10 javë

Koha e cila përafërsisht nevojitet që polistireni i ekspanduar 035 (100mm) në mure të jashtëm ta kthejë energjinë që është shpenzuar në prodhimin e tij.

#### Prodhimet tona

Leshi minerali qelqor (GMW), leshi mineral guror (RMW), leshi druror (WW), polistireni i ekstruduar - stirodur (XPS), dhe polistireni ekspanduar – stiropor (EPS) dhe polietileni i ekstruduar (XPE).

Prodhimet tona janë vendimtare për qëndrimin e mjedisit të ndërtuar. Ata kthejnë shumë më tepër energji se sa kërkon prodhimi i tyre dhe kanë rëndësi vitale për ndërtesa të qëndrueshme. Ja pra çka mund të të bëjë një prodhim i qëndrueshëm?

E para, Knauf Insulation i ka kushtuar kohë kuptimit të secilës fazë të procesit të prodhimit të një prodhimi të qëndrueshëm përmes analizës së ciklit jetësor (LCA). Me rezultatet e arritura i kemi shtruar vetitë detyrën e përmirësimit të mjedisit të jetesës me anën e proceseve tona prodhuese. Kemi marrë përsipër të kryejmë analizën e ciklit jetësor në të gjitha fabrikat tona deri në fund të vitit 2011.

E dyta, prodhimet tona janë punuar prej një seri mterialesh duke përfshirë këtu edhe resurset e begatshme dhe të pashterrshme siç është druri në leshin druror ose guri në leshin mineral guror dhe meterialet e ricikluara siç është rasti me CD –t në polistiren të ekstruduar dhe me xhamin në leshin mineral qelqor. Gjatë viteve të kaluara në mënyrë konstante e kemi paksuar sasinë e resurseve të kufizuara që i shfrytëzojmë e njëherit me një ritëm të shpejtuar e kemi shtuar përmbajtjen e atyre që janë përtritit dhe ricikluar.

#### 05 11 Obligimi

Komponente prodhimesh dhe LCA të prodhimeve tona  
Shikoni faqen 9 për të gjitha detajet.



Të dini më tepër për faktin se sa janë të qëndrueshme prodhimet tona  
[www.knaufinsulation.com/en/buildings\\_solutions](http://www.knaufinsulation.com/en/buildings_solutions) [www.oem.knaufinsulation.com/](http://www.oem.knaufinsulation.com/)

## Krijimi i zgjidhjeve inovatorike



## Niveli superior i qëndrueshërisë me ECOSE® Technology.

INë vitin 2009 kemi lansuar asortimentin e ri të leshit mineral me ECOSE® Technology, çka është një teknologji e re revolucionare e materialeve të ndërlidhura pa formadehide, e bazuar në materiale që shpejt përtërihen në vend të substancave kimike në bazë të naftës. Ajo është e liruar nga formaldehidi, fenola, akrili. Në të nuk ka ngjyra artificiale, substanca për zbardhim ose pigmente. Kjo teknologji është një hap përpara në ndryshimin e performansave të qëndrueshmërisë, kurse në të njëjtën kohë i ruajnë performansat e larta të izolimit. Duke eliminuar fenolin dhe formadehidin (PF), procesi i emisionit brenda impiantove zvoglohet në mënyrë të konsiderueshme, sikur edhe emisionet prodhuese në ambientin e jetesës.

#### 04 Obligimi

Komponentet e prodhimeve

Shikoni faqen 9 për të gjitha detajet



## 0%

Sasia e fenolit dhe e formadehidit që i shtohet leshit mineral qelqor me ECOSE® Technology.

## 85%

Në vitin 2010 kemi pasur edhe deri 85% të përmbajtjeve të ricikluara në leshin tonë mineral qelqor me ECOSE® Technology.



**Rruga jonë që të bëhemi një kompani akoma më e qëndrueshme është fakti se kompania mbështetet në një prodhim me përgjegjësi, në mirëqenien e të punësuarve, komunitetin shoqëror dhe mjedisin e jetesës. Duke zgjedhur këtë rrugë Knauf Insulation analizon aktivitetet e veta, objektivat e veta dhe përparimin në lidhje me sigurinë, shëndetin e mirëqenien e të punësuarve, energjinë e menaxhimin e mjedisit të jetesës**

**24%**

Në sajë të sistemit të integruar të menaxhimit tani janë evidencuar më shumë aksidente dhe si është pritur, kjo e ka ngritur edhe frekuentimin e LTA për 24%.

## Të punuarit me përgjegjësi

### Implementimi i sistemit të integruar të menaxhimit për vend pune më të mirë e më të sigurt.

Repartet prodhuese janë përgjegjëse për implementimin e politikës sonë globale të shëndetësisë, sigurisë e të mjedisit të jetesës, përmes sistemit të integruar të menaxhimit të reparteve të prodhimit. Shumica e fabrikave i kanë Këshillat e sigurimit pa marrë parasyshse a është ky obligim ligjor apo jo. Sistemi ynë informues i sigurimit tani përmbanë përkufizime të reja të reviduara të fatkeqësive apo aksidenteve nëpër sektore të ndryshme. Sistemi i integruar i menaxhimit bënë të mundshëm evidencimin me preciz të numrit të asidenteve që kanë ndodhur, dhe siç është pritur, ky fakt e ka ngritur frekuencën e LTA për 24%, kurse aksidentet serioze janë zvogëluar për 33%. Singërisht na vjen keq që në vitin 2009 ka ndodhur një rast kur e humbi jetën një zbatues i punimeve. Duhet të marrim mësimë prej këtyre rasteve : brenda 24 ore të gjithë menaxherët e fabrikave si edhe ata të tjerët që ushtrajnë pozita të ngjashme janë informuar për shkaqet e këtij aksidenti. Atë që kemi mësuar nga ky akcident, e kemi intergruar në sistemin tonë të menaxhimit për të penguar që të mos na ndodhin më raste të tilla.

#### 01 02 Obligimi

Qëdrimi ndaj menaxhimit

Shikoni faqen 9 për të gjitha detajet.

**-33%**

Rastet serioze aksidentale janë zvogëluar 33%.

*Knauf Insulation Mbështet në mënyrë aktive programet që ndihmojnë komunitetin, prej projekteve e deri te debatimet publike. Në Krupkë, në Republikën e Çekisë, të gjitha aktivitetet kanë përfshirë edhe programet e mbështetjes dhe një bashkëpunim afatgjatë me të gjitha organizatat joqeveritare e gjithashtu edhe projektet ad hoc siç është renovimi i mureve të Këshjtjellës së Krupkës.*



**ONE**

Knauf Insulation «ambasadorët» Në fillim të fushatës ,më 2009.



## Njerëzit dhe komuniteti

### Mirëqenia e të punësuarve tanë dhe e komunitetit tonë lokal është vandimtare.

#### Njerëzit tanë

Sikur edhe pjesa më e madhe në treg, Knauf Insulation është ballafaquar me disa sfida gjatë viteve 2009 e 2010. Mirëpo, megjithë klimën e vështirë ekonomike dhe humbjes së disa vendve të punës, para neve është një e ardhme e ndritshme. Në vitin 2010, e kemi ngritur në një nivel më të lartë mirëkuptimin midis të punësuarve kemi përparuar menaxhimin e resurse në njerëz gjatë viteve 2009 – 2010, dhe në bazë të nismave globale, kemi marrë përsipër që ky prosperitet të ngritet në nivel akoma më të lartë gjatë vitit 2011.

#### Komuniteti ynë lokal

Kemi një seri projektesh të nivelit lokal të cilat i përgjigjen nevojave të komunitetit. Me nisma kuptojmë fushatat lokale që nxisim familjet që të paraqiten për izolime gratis; jemi sponsorë të rre gullt të projekteve lokale: për shembull, në Gjermani, Slloveni dhe në Republikë të Çekisë dhe këto janë projekte për aktivitete lokale sportive dhe për shkolla, në SHBA për zjarrëfikës dhe në Britani të Madhe për organizata humanitare për fëmijë dhe për fushatën e efikasitetit energjetik " The Great British Refurb campaign". Kemi për qëllim të jemi fqinjë i mirë dhe kryesisht këtë qëllim jemi duke realizuar. Video-ja jonë për marrëdhëniet fqinjësore tregon një pasqyrë të sinqertë e reale të përvojave të palve të interesuara lokale duke përfshirë edhe faktin se si Knauf Insulation i është përgjigjur këtyre kërkesave të komuniteteve lokale.

#### 03 Obligimi

Mirëqenia e të punësuarve

Shiko faqen 9 për të gjitha detajet



Shikojeni filmin në

[www.knaufinsulation.com/en/corporate\\_responsibility](http://www.knaufinsulation.com/en/corporate_responsibility)

## Mjedisi i jetesës

**Menaxhimi i mjedisit të jetesës në kombinim me sistemin e integruar të manaxhimit na ka ndihmuar të përcjellim më mirë shfrytëzimin e energjisë, emisionin e gazrave të kopshteve me xhama, materialet e ndryshme, hedhuritë, ujin, transportin dhe ambientin e zyrave.**

Çështja e energjisë për neve është çështje kyçe. Duke u bazuar në rezultate e kursime të mëdha gjatë dhjetë viteve të kaluara, kemi vazhduar të shënojmë rënie të përdorimit të energjisë për tonë të prodhimit-krahas rënies prej diçka më pak se 1 % gjatë periudhës 2008- 2009. Jemi duke shfrytëzuar burime të ndryshme të energjisë nëpër fabrika tona duke përfshirë edhe disa burime të rindërtuara të tjera të energjisë. Intesiteti total i karbonit te neve ka rënë për 11% gjatë viteve 2008-2009.

Bëjmë përpjekja të zvogëlojmë edhe sasinë e hedhurive që krijohen dhe të zvogëlojmë edhe hedhuritë e ambalazhit. Në mënyrë konstante jemi duke shtuar sasinë e materieve të recikluara të cilat shfrytëzohen në procesin e prodhimit. E kemi të qartë se edhe mënyra e transportit mund të sjellë dobi për mjedisin e jetesës. Do të zhvillojmë kërkime në sferën e transportuesve tanë dhe do të bëjmë promovimin e një transporti me përgjegjësi e adekuat përmes praktikës së furnizimit.

Për neve është evidente se masat e ndërmarra në sferën e ujit kanë pasur efekte – gjatë vitit 2009 kemi shfrytëzuar më pak ujë për një tonë prodhimi. ( 18,3% më pak), edhe pse gjatë vitit 2009 kemi lëshur 33% më shumë ujë.

### 06 07 08 09 Obligimi

Reciklazhi në procesin e prodhimit, reciklazhi në logjistikë, Energjia në afarizëm dhe transport

Shiko faqen 9 për të gjitha detajet

**-11%**

Intesiteti i karbonit  
Zvogëlimi intensitetit global të karbonit në vitin 2009.

**126,000**

Paleta janë recikluar në Britani të Madhe gjatë vitit 2009.

**+18.3%**

Intesiteti i shfrytëzimit të ujit  
Për tonë prodhimi shfrytëzojmë më pak ujë.

## Obligimi ynë

### 01 Akceptimi në menaxhim:

Vendosja e sistemit të integruar të shëndetësisë e të sigurisë mbarë Europës dhe Bashkimit të shteteve të pavarura

### 02 Akceptimi në menaxhim:

Implementimi i ISO 14001 në fabrika mbarë Europës dhe në Bshkimitin e shteteve të pavarura deri në fund të vitit 2011.

### 03 Mirëqenie e të punësuarve:

Obligim e reja në planin e mirëqenies së përgjithshme deri në periudhën tjetër të raportimit , 2011.

### 04 Komponentet e prodhimeve:

Të vazhdohet puna në përjashtimin e fenolit dhe të formaldehidit dhe në gjetjen e alternativës për HBCD (Hexabromocyclododecane)

### 05 Elementet përbërse të prodhimit:

Të vazhdojnë kërkimet e mënyrave me të cilat do të mund të shtohet përdorimi i materialeve të recikluara nga burimet post konsumore dhe post burimeve industriale në asortimentin tonë konsumues.

### 06 Reciklazhi në procesin e prodhimit:

Informimi për shkallët e reciklazhit dhe zbatimi i objektivave të përparimit në Europë dhe në Bashkimitin e shteteve të pavarura.

### 07 Reciklazhi në logjistikë:

Pasqyra e kthimit të paletave në tërë Knauf Insulation në Europë dhe në Bashkimitin e shteteve të pavarura

### 08 Energjia në veprimtarinë afariste:

Identifikimi i disa mundësive për burime përtëritëse të energjisë.

### 09 Transporti:

Të jipen informacione për transportit global që ka të bëjë me performasat e karbonit në vitin 2011.

### 10 Shfrytëzimi i energjinë në ndërtesa:

Të kryhet inventarizimi i fondit tonë ndërtimor me qëllim të zhvillimit e të implementimit të programit efikas të renovimit në pikëpamje të energjisë.

### 11 Analiza e ciklit tonë të jetesës:

Të implementohet LCA në të gjitha fabrikat tona deri në fund të vitit 2011.

## Si mund të ndihmoni Ju

Kontributi ynë në lidhje me ekzistimin nuk merr fund këtu. Në mënyrë konstante jemi duke punuar në zhvillimin e qëndrimit global për kuptimin e ndikimit tonë ndaj ekzistimit dhe në marrjen e aksioneve për përmirësime tjera.

Jemi duke vazhduar punën tonë për tu pozicionuar në lidhje me çështjet vitale dhe për

ndërmarrjen e aksioneve përkatëse me palët më të rëndësishme të interesuara në mënyrë që ti realizojmë ambicjet tona.

**Tony Robson**  
Mars, 2011.

